

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË PËRURIMIN E SALLËS SË MEDIAS
DHE SALLËS TË RIKONSTRUKTUAR TË KOMISIONIT TË LIGJEVE NË KUVEND**

23 maj 2012

Shkëlqesia Juaj Kryetare e Kuvendit,
I ngarkuari me punë, zoti Tintrup,
Të nderuar të ftuar,
Zonja dhe zotërinj,

Përpara se të filloj, dëshiroj të vlerësoj solidarizimin plot dinjitet të qytetarëve shqiptarëve, pas aksidentit tragjik pranë Himarës. Me ndjenjat tona gjendemi pranë viktimave dhe familjeve të tyre. U urojmë të lënduarave shërim të shpejtë e të plotë.

Lejomëni t'i kthehem veprimtarisë së sotme. Në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, jam i kënaqur që ndodhem me ju, në ceremoninë e përrurimit të sallës model të komisioneve parlamentare, si dhe të mjediseve të punës për median.

Do të doja të përgëzoja Kryetaren dhe ekipin e saj për punën e vështirë e për angazhimin që kanë treguar për të arritur deri këtu.

Kuvendi përbën një institucion kyç të demokracisë në Shqipëri.

Është vendi ku debati dhe diskutimet e hapura dhe të ndershme mund të sjellin në jetë *shpirtin e demokracisë*.

Është vendi përmes të cilit shprehet vullneti i popullit, miratohen ligjet dhe i kërkohet llogari qeverisë.

Është vendi që është në gjendje të përfaqësojë dhe të flasë për gjithë popullin e Shqipërisë.

Është vendi ku bëhen publike zgjedhjet para të cilave gjenden politikëbërësit dhe që ndihmon për ta informuar publikun rreth tyre.

Këto katër cilësi të Kuvendit përbëjnë thelbin e vërtetë të një demokracie në shekullin XXI.

Dhe, në pothuajse në të gjitha demokracitë moderne, procesi i demokratizimit është rrallëherë, në mos asnjëherë, një ngjarje që ndodh vetëm një herë.

Ai është më tepër një seri evolucionare reformash të ndryshme dhe një diskutim i hapur rreth politikave më të mira për t'u shërbyer më mirë njerëzve, dhe kështu sovranit të vërtetë të një vendi demokratik.

Kështu ka ndodhur edhe këtu në Shqipëri.

Gjatë 10 vjetëve të fundit, falë punës së madhe të lidershit të Kuvendit, nga të gjitha palët politike, një progres madhor është bërë në forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të parlamentarëve, stafit të Kuvendit dhe përmirësimit të infrastrukturës së tij.

Për këto arsye, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është e kënaqur të vazhdojë të mbështesë Kuvendin për të zhvilluar më tej rolin dhe kapacitetet e tij institucionale.

Qysh prej vitit 2002, me mbështetjen financiare të Vendeve të Ulëta, Austrisë dhe Gjermanisë, mbështetja e Prezencës ka përfshirë transmetimin direkt të seancave plenare në internet, futjen në përdorim të praktikave dhe infrastrukturës së re të teknologjisë së informacionit, së bashku me modernizimin e mëtejshëm të ambienteve të bibliotekës dhe mundësive për kërkime.

Në vitin 2011, mbështetja nga Prezenca u fokusua në rritjen e mundësive të publikut për t'u informuar rreth parlamentit nëpërmjet infrastrukturës së modernizuar të arkivimit; dixhitalizimit të dosjeve të arkivës; krijimit të një salle pune për median dhe përmirësimit të një salle komisioni model në zyrat e Kuvendit.

Dhe kështu dalim tek arsyeja që na bën të jemi sot paradite këtu, në këtë ndërtesë.

Siç e kemi parë të gjithë, në praktikë, për shkak të detyrimeve të tyre, shumica e qytetarëve nuk kanë mundësi ta vizitojnë parlamentin personalisht.

Prandaj, që punimet parlamentare të jenë vërtet të aksesueshme për publikun, ato duhet të jenë vërtet të hapura ndaj medias, e cila mund të veprojë si 'sytë dhe veshët' e publikut.

Megjithatë, informimi i publikut rreth punës së parlamentit nuk është thjesht një çështje që i takon medias së pavarur.

Informimi i publikut rreth parlamentit është edhe një përgjegjësi për vetë parlamentin.

Salla e punës së medias që ne po inaugurojmë sot do ta ndihmojë median që të ketë më lehtë akses në rezultatet e mbledhjeve të komisioneve dhe dokumenteve parlamentare.

Kjo sallë do të jetë një vend i përshtatshëm, ku media mund të takohet dhe të diskutojë.

Salla e përmirësuar model e komisioneve do të ofrojë një ambient më miqësor për përdoruesit, ku mund të zhvillohen bashkërisht mbledhjet e komisioneve dhe seancat dëgjimore publike.

Kjo sallë do të rrisë aksesin për publikun dhe median përmes një mini-galerie publike brenda sallës.

Në këtë pikë, do të doja të falënderoja qeverinë gjermane për kontributin e saj financiar në këtë proces.

Këto ndryshime të tjera vetëm do ta ndihmojnë parlamentin shqiptar që të bëhet më transparent dhe më i përgjegjshëm në sytë e publikut.

Këto ndryshime do të ndihmojnë për ta bërë publikun që të ndihet më shumë zot i procesit demokratik – dhe do të forcojnë kështu legjitimitetin e tij.

Zonja Kryetare,
Të nderuar miq,
Zonja dhe zotërinj,

Për ta mbyllur, siç mendoj se e dimë të gjithë, parlamentet nuk janë thjesht ndërtesa, orendi e pajisje.

Ajo çka është vendimtare është se qëllimi i tyre është garantimi i marrjes së vendimeve të rëndësishme që ndikojnë në jetët e njerëzve.

Në këtë kuptim, do të doja të përmendja disa vendime të rëndësishme që do të duhet të merren së shpejti nga parlamenti.

Së pari, reforma e kodit zgjedhor.

Kuvendi është tashmë shumë afër mbërritjes në 'vijën e *finish-it*' si rezultat i gjithë punës së vështirë që është bërë nga të gjitha palët politike, qysh prej nëntorit të vitit të kaluar.

Unë u bëj thirrje të gjitha palëve që të mos harrojnë se ato i marrin karriget e tyre në Kuvend për t'i shërbyer vullnetit të shprehur të popullit shqiptar.

Dhe populli shqiptar duhet të shohë një Kod Zgjedhor të miratuar në mënyrë konsensuale, mbi bazën e të cilit mund të zhvillohet zgjedhje të suksesshme vitin e ardhshëm.

Së dyti, procesi i zgjedhjes së Presidentit.

Unë shpresoj të shohim një proces me një frymë të mirë.

Unë shpresoj të shohim një proces kushtetues që t'i tregojë popullit shqiptar se si mund të bashkohen përfaqësuesit e zgjedhur për interesin kombëtar në zgjedhjen e Kreut të Shtetit.

Unë shpresoj të shohim shumë mirëkuptim dhe, në rastin më të mirë, një President të ri të zgjedhur bashkërisht.

Dialogu i vazhdueshëm midis politikanëve kryesorë përçon sinjalet më shpresëdhënëse.

Konsensusi politik për çështjet themelore është i nevojshëm.

Kjo do ta ndihmojë Shqipërinë të përmbushë aspiratat e saj kombëtare drejt familjes evropiane të kombeve.

Së treti, dëshiroj t'ju ftoj që ta shihni përrurimin e sotëm si një mbështetje për procesin e rëndësishëm, në vazhdim e sipër, të reformës parlamentare.

Zonja dhe zotërinj, ju faleminderit!

Fund